



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 83, QARKU VLORË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 14.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	Bitri-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 83, Qarku Vlorë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 93 dhe neni 94, pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1569 prot., datë 20.03.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Vlorë, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Vlorë që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar si dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015. për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për dhjetë (10) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 1569/1 prot., datë 09.05.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për secilën nga VNV-të e Qarkut Vlorë.



Nr. 326 i Vendimit Data 14.05.2019 e Vendimit Ora 14.⁰⁰ e vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.83, Qarku Vlorë,
për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në nr. 83, Qarku Vlorë, është:

1. Palestra e shkollës "Ali Demi", me sipërfaqe 540m², Bashkia Vlorë;

Ambjenti i palestrës së shkollës "Ali Demi", ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizmit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr.83, në Palestrën e shkollës "Ali Demi", me sipërfaqe 540m², Bashkia Vlorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement ZGURI Kryetar

Denar BIBA Zëvendëskryetar

Bledar SKËNDERI Anëtar

Edlira JORGAQI Anëtare

Rezarta BITRI Anëtare



Nr. 326 i Vendimit Data 14.05.2019 e Vendimit Ora 14.00 e vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.83, Qarku Vlorë,
për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019